

## SHËRBESA E BLATËS

*Prifti dhe Dhjaku qendrojnë përpara Deres së Bukur, dhe falen tri here.*

DHJAKU: Bekó, o Atë.

PRIFTI: I bekuar është Perendia ynë, gjithënjë, taní e përherë dhe në jetet e jeteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Lavdí ty, o Perendia ynë, lavdí me ty.

DHJAKU: O Mbret qëllor, o ngushëllimtar, o shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudó, dhe i mbush të gjitha, thesár i të mirave dhe fals i jetës, eja dhe tendesó nër në, dhe spastrona prej çdo njolle, dhe shpëtoji shpirtet tona, o i mirë.

Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

Triní e tërëshenjte, meshirona; o Zot, hirësoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhësitë tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe shëroji sëmundjet tona për emrin tënt. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati ynë, që je në qell, u-shenjtëroftë emri yt; arthte Mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si në

qell edhe mi dhé; buken tone te perdçime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tane; edhe mos na shtjer ne nga-sje, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Prifti dhe Dhjaku pershendoshin konizmat e Krishtit e te Shen Marise, dyke kenduar ketó Tropare:*

Konizmen e bekuar po adhurojme beserísht, dhe ndjese po te lypim per fajet edhe mekatarat tona o Krisht Perendí, se deshe dhe dignove te mberthehesh mi Kryqin truperísht, dhe nga zgjedha e djallit na shpetove dhe na dhé lirí; pra po te therresim me perhirím: Me gas i mbushe qe te gjitha Shpetimtár Jesú, se ti ke ardhur per shpetimin e botes.

O burím i dhempsherive, o Hyjlíndese, kij meshire per né; shtjer syrin mi mekatarët, edhe shpetona me fuqine tende; se me ty shperejme dhe ty te therresim, me pershendoshjen engjellore te Gabrielit: Gezohu, o Virgjereshe hirplote.

*Pastáj qendrojne perseri perpara Deres se Bukur, ku Prifti thote keté Urate:*

PRIFTI: Zgjat-e doren nga qelli, o Zot, edhe forcome qe te qendronj perpara Alltarit tent, edhe ta mbarónj Meshen e shenjte faqebardhe.

Se jotja eshte fuqia dhe lavdia. Amín.

*Passi falen tri here, dhe pershendoshin pópullin, hyjne ne Shenjteroren, Prifti nga dera e veriut dhe Dhjaku nga dera e juges, dyke thene:*

Do te hynj ne Shenjteroren tende, dhe do ti falem Trinise, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, per jete. Amín.

*Pastáj pershendoshin Ungjillin e Shenjte dhe Alltarin, marrin Stiharin ne dore, dhe falen tri here, dyke thene:*

O Perendí, me fal mekatarin, edhe meshirome.

*Dhjaku, dyke mbajtur robot e shenjta, i afrohet Priftit, edhe thote:*

DHJAKU: Bekó, o Ate, Stiharin dhe Orarin.

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia yne, gjithenjé, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

DHJAKU: Amín.

*Pastáj Dhjaku puth doren e Priftit, i cili ia bekón robot, edhe vishet, dyke puthur çdo robe. Gjithashtú vishet edhe Prifti, passi kryqesón, edhe puth çdo robe, dyke thene:*

PER STIHARIN: Shpirti im do te ngazellohet me Zotin, se me veshi me roben e shpetimit, edhe me peshtolli me kemishen e gezimit; se me kurorezój posi dhenter, dhe me stolisi posi nuse. Gjithenjé, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

PER MENGËN I: Dora jote e djathte, o Zot, u-lavderua me fuqí; dora jote, o Zot, i dermój armiqte dhe kundertshtarët.

PCR MENGËN II: Dúart' e tua me benc, dhe me gatuan; urtesome, dhe do ti mesónj porrosít' e tua.

PCR PETRAHILIN: I bekuar eshte Perendia, qe derdhi hirin mi prifterínjt' e tij, si myrren mi kokën e Aaronit.

PCR BREZIN: I bekuar eshte Perendia, qe me ngjeshi me fuqí, dhe ma bëri udhën faqebardhë.

PCR EPIGONATIN: Ngjesh-e kordhën permi kofshën, o i fortë, i bukur dhe i mirë; dhe shko përpara faqebardhë, dhe mbretëro me të vertetën, me butësinë dhe me drejtësinë; dhe dora jote e djathtë do të udhëheqë çuditërisht. Gjithenjë, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín.

PCR FELLONIN: Prifterínjt' e tu, o Zot, do të vishen me drejtësi, dhe oshenarët e tu do të gëzohen me ngazellím. Gjithenjë, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín.

*Pastáj Prifti dhe Dhjaku i lajné dúarte, dyke thënë:*

Do ti lanj dúart' e mia me të pafajmet, edhe do të rotullónj reth Alltarit tënt, o Zot. Gjithenjë, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín.

*Pastáj shkojnë në Tryezen e Blates, edhe falen tri here, dyke thënë:*

O Perendí, më fal mekatarin, edhe meshiromë.

*Pastáj Prifti e merr Buken e Meshes dhe Shtëjezen me të dyja dúarte, i ngre gjer në ballë, dhe thote:*

PRIFTI: Na çpërbleve prej mallkimit të ligjes

me Gjakun e çemuar; se u-mbertheve mi Kryqin, dhe u-çpove me shtëjçzen, dhe na fale jeten e ameshuar, o Shpëtimtari ynë, lavdí me ty.

DHJAKU: Bekó, o Atë.

*Pastáj Prifti, dyke mbajtur Buken e Meshes me dorën e mëngjer dhe Shtëjezen me dorën e djathtë, bën shenjen e Kryqit me ató, dhe thote:*

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia ynë, gjithënjé, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

DHJAKU: Amín. Le ti lútemi Zotit.

*Pastáj Prifti bën shenjen e Kryqit me buken e Meshes me Shtëjezen, dhe thote:*

PRIFTI: Për kujtím të Zotit edhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesú Krisht.

DHJAKU: Gjithenjë, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín. Le ti lútemi Zotit.

*Pastáj Prifti pret me Shtëjezen Shilen e katerçipte të Bukes së Meshes, dyke nisur nga ana e djathtë, pastáj nga e mëngjera, pastáj nga e sipërmja dhe më në fund nga e poshtëmja, dyke thënë:*

PRIFTI: Si dele u-hoq në therje.  
Dhe si shqerrë e pafajmë nuk e hapi gojën.  
E humbi gjykimin nga poshtërimet.  
Po brezín e tij kush do ta tregonjë?

DHJAKU: Ngrer, o Atë.

*Pastáj Prifti, dyke ngulur Shtëjezen brínjazi nga ana e mëngjer, e ngre Shilen e katerçipte të Bukes së Meshes, dhe e ve mi Dhiskun, dyke thënë:*

PRIFTI: Se jeta e tij u-ngrit prej dheut.

DHJAKU: Sakrifikó, o Ate.

*Pastáj Prifti e kthen Buken e Shenjte prápetaj mi Dhiskun, e pret tulin e saj kryqthi, dhe thote:*

PRIFTI: Sakrifikohet Qengji i Perendise, qe ngre mekatin e botes, per jeten dhe shpetimin e botes.

DHJAKU: Çpo, o Ate.

*Pastáj Prifti e kthen Buken e Shenjte per se mbari nga shila, e çpon me Shtijezen nga ana e djathte, dhe thote:*

PRIFTI: Nje prej ushtáreve ia çpoj brinjen me shtijezen, dhe menjherë rodhi gjak e uje. Dhe aý, qe e ka parë, e desh imó, dhe deshmimi i tij esht i vertete.

*Pastáj Dhjaku, dyke mbajtur enen e veres me doren e djathte dhe enen e ujes me te mëngjeren, shtie vere dhe uje ne Kupa e Shenjte, dyke thene:*

DHJAKU: Bekó, o Ate, bashkimin e shenjte.

PRIFTI: I bekuar eshte bashkimi i te shénjtave te tua.

DHJAKU: Gjithenjé, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

*Pastáj Prifti merr Meshen e dyte, e kryqesón me Shtijezen, dhe pret nje cope te triçipte, dyke thene:*

PRIFTI: Per nder dhe kujtím te Shen Marise.

*Pastáj Prifti e ngre pjesen e Shen Marise, dhe e ve me anen e djathte te Bukes se Shenjte, dyke thene:*

PRIFTI: Qendrój Mbretresha nga ana jote e

djathte, e veshur me roba te florinjta dhe te ndrícime.

*Pastáj Prifti nxier me Shtijezen nente cope te vogla, te cilat i radhit ne tri sere nga ana e mëngjer e Bukes se Shenjte, dyke thene:*

I. Per nder dhe kujtím te Shen Mchillit edhe te gjithë Engjejeve te shenjte.

II. Per nder dhe kujtím te Shen Joán Pagezorit edhe te gjithë Proféteve.

III. Per nder dhe kujtím te Shen Pjetrit, te Shen Palit edhe te gjithë Apostujve te shenjte.

IV. Per nder dhe kujtím te Shen Basilit, te Shen Grigorit, te Shen Joán Gojartit edhe te gjithë Kryepřifterve te shenjte.

V. Per nder dhe kujtím te Shen Stefanit, te Shen Gjergjit, te Shen Mitrit edhe te gjithë Deshmóreve te shenjte.

VI. Per nder dhe kujtím te Shen Andonit edhe te gjithë Ashketinjve te shenjte.

VII. Per nder dhe kujtím te Shen Kozmajt, te Shen Damianit edhe te gjithë Mjékeve te shenjte.

VIII. Per nder dhe kujtím te Shen Joakimit e Shen Annes; te Shen Josefit e Shen Simeonit; te Shenjtit te dites (*aksh*), te cilin po lusim sot; edhe te gjithë Shenjtóreve.

IX. Per nder dhe kujtím te Shen Joán Gojartit (*ose te Shen Basilit*), Meshen e te cilit po bejme sot. O Shenjt i Perendise, nermjetó per né.

*Pastáj Prifti pret dy pjesa nga Buka e Meshes, nje per te gjallet edhe nje per te vdëkurit. Merr pjesen e te gjálleve, dhe kujtón te gjallet, dyke nxiere therrime te vogla, te cilat i radhit nene Buken e Shenjte:*

- I. Kujtó, o Zot, çdo Peshkopate Orthodoxkse.
- II. Kujtó, o Zot, Kryepeshkopin tone (aksh).
- III. Kujtó, o Zot, Peshkopin dorezonjes (ne qofte i gjalle).
- IV. Kujtó, o Zot, Vellazerine tone me Krishtin.
- V. Kujtó, o Zot, te gjithë te Krishterët besemire.
- VI. Kujtó, o Zot, Presidentin tone.
- VII. Kujtó, o Zot, sherbetoret e tu (aksh).

*Ketú Prifti kujtón te gjallet, per te cilet behet Mesha, te cilet e porrositne ti kujtonje, dhe te cilet desherón aj vete. Pastáj e le pjesen e te gjálleve, merr pjesen e te vdëkurve, dhe kujtón te vdëkurit:*

- I. Kujtó, o Zot, themeltarët e kesáj Kishe se shenjte.
- II. Kujtó, o Zot, Peshkopin dorezonjes (ne qofte i vdekur).
- III. Kujtó, o Zot, te gjithë te Krishterët besemire, qe prehen ketú dhe kudó.
- IV. Kujtó, o Zot, sherbetoret e tu (aksh).

*Ketú Prifti kujtón te vdëkurit, per te cilet behet Mesha, per te cilet esht i porrositur, dhe te cilet desherón aj vete. Pastáj e le pjesen e te vdëkurve, merr perserí pjesen e te gjálleve, dhe kujtón veten e tij:*

PRIFTI: Kujtó, o Zot, edhe pavleresine time,

dhe fal-me çdo faj te dashur dhe te padashur.

*Pastáj Dhjaku me Temjanicen te pregatitur vjen perpara Priftit, edhe thote:*

DHJAKU: Bekó temjanin, o Ate.

PRIFTI: Temján po te blatojme, o Krisht, o Percendia yne, si arome shpirtore. Prit-e ne qell perpara Alltarit tent, edhe dergona si çperblím hirin e Shpirtit Shenjt.

*Heth temján ne Temjanicen, merr Yllthin, e afrón mi Temjanicen, pastáj e ve mi Buken e Shenjte, dyke thene:*

PRIFTI: Dhe ardhi Ylli, dhe qendrój persiper, atjé ku ishte Djali.

*Pastáj merr Mbulesen e pare, e afrón mi Temjanicen, dhe e ve permi Dhiskun e Shenjte, dyke thene:*

PRIFTI: Zoti mbreterój, u-vesh me madheshtí.

*Pastáj merr Mbulesen e dyte, e afrón mi Temjanicen, dhe e ve permi Kupen e Shenjte, dyke thene:*

PRIFTI: Virtuti dhe lavderimi yt, o Krisht, kane mbuluar qellin e dhene.

*Pastáj merr Mbulesen e madhe, e afrón mi Temjanicen, dhe e ve mi Dhiskun e mi Kupen, dyke thene:*

PRIFTI: Mbulona nene hien e fléteve te tua; largó prej nesh te gjithë armiqtë dhe kunder-shtaret; paqesona jeten; meshirona, o Zot; edhe shpctoji shpirtet tona, si i mire dhe njeridashes.

*Pastáj merr Temjanicen, e temjanís tri here Tryezen e Blates, dhe ia kthen Temjanicen prape Dhjakut.*

DHJAKU: Per blaten e Dhuratave te çmúara,

le ti lútemi Zotit.

PRIFTI: O Perendi, qe na dergove Buken e qellit e te dheut, Zotin dhe Perendine dhe Shpëtimtarin tone Jesú Krisht, ti bekoje këtë Blate, dhe prit-e përpara Alltarit tent qëllor; kujtoji, o Zot, te gjallet e te vdekurit, për te cilet u-blatua; dhe rúajna faqebardhe në shërbimin e Mistèreve te tua te perendishme. Se emri yt është i shenjte dhe i lavdëruar, i Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

DHJAKU: Amín.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

DHJAKU: Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Ate.

*Pastáj Prifti ben Perleshimin e Shkurter:*

PRIFTI: Krishti, Perendia yne i vertete, me nermjetimet e Shen Marise; te Shen Joán Gojartit, kryepeshkopit te Kostandinopojes (ose te Shen Basilit te Math, kryepeshkopit te Kesarise se Kappadoqise) te Shenjtit te Kishes sone (aksh); te Shenjtit te dites (aksh), te cilin po lusim sot; edhe te gjithe Shenjtóreve; na meshirofte, dhe na shpëtofte si i mire dhe njeridashes.

DHJAKU: Amín.

*Pastáj Prifti dhe Dhjaku falen tri here, dhe pershendoshin Dhuratat e Shenjta kryqthi, dyke thene:*

Shenjt Perendí, Ati i panismë; Shenjt i fuqishim, Biri i bashkepanismë; Shenjt i pavdekur, Shpirti Shenjt; Triní e tereshenjte, lavdí me ty.

*Dhjaku temjanis Tryezen e Blates, Alltarin dhe tere Kishen, dyke kenduar Psalmin 51. Kur kthehet prape, e varr Temjanicen, dhe falet me Priftin tri here përpara Alltarit, Prifti pershendósh Ungjillin; Dhjaku puth Alltarin, pastáj unjet, edhe i thote Priftit, dyke mbajtur Orarin me tre gishterinjte e dores se djathte:*

DHJAKU: Ardhi koha ti shërbejmë Zotit. Bekó, o Ate.

PRIFTI: I bekuar është Perendia yne, gjithënjé, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

DHJAKU: Amín. Lutu për mua, o Ate.

PRIFTI: Zoti i drejtofte çapet e tua me çdo veper te mire.

DHJAKU: Amín. Kujtome, o Ate.

PRIFTI: Zoti Perendí e kujtofte dhjakerine tende në Mbretërin' e tij. Gjithënjé, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

DHJAKU: Amín.

*Pastáj Dhjaku puth doren e Priftit, del përpara Deres se Bukur, dhe thote me ze te larte: "Bekó, o Ate." Prifti nis Meshen.*